



Financimi 250 mln euro në bujqësi, Rrapaj në Report Tv: Mbi 100 mijë përfitues! Çoçoli: Njihen vitet e punës edhe pa dokumente për...

Faqe 3



Komisioni European mbështet AZHBR-në për përmirësimin e teknikave të auditimit

Faqe 2



Mata: Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, rreth 87 milionë dollarë në mbi 37 projekte në arsim

Faqe 2



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit janar 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 502
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

BANKA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT

FINANCIMI 250 MLN EURO NË BUJQËSI, RRAPAJ: DO T'I NDIHMOJË SHUMË FERMERËT, BANKAT FRIKËSOHEN TË JAPIN KREDI, PASI SHIHET SEKTOR ME RISK

Qeveria ka prezantuar një instrument të ri bankar me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh, për të lehtësuar aksesin në kredi për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Lidhur me këtë propozim, kryetari i Këshillit të Agrobiznesit, Agim Rrapaj u shpreh se kjo është një nismë që do t'i vijë në ndihmë fermerëve

ALBANIA

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Siguria ushqimore, Denaj: Kush abuzon, do të shkojë për ndjekje penale



Faqe 4

BUJQËSI

Dhuli: Brenda vitit hartohet projektligji për realizimin e Censit të Bujqësisë

Faqe 4

KËNDI I EKSPERTIT



Nevoja për shoqërues të trajnuar për turistët, vizitorë të zonave fshatare

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Mungesë tregu për bimët mjekësore në Kukës, grumbulluesit kërkojnë mbështetje Fq.4
- "Paketa e Maleve", zhvillim për zonat malore - Dervishi: Vëmendje ti kushtohet edhe ndërtimeve në zonat e mbrojtura Fq.5
- Dy platforma për guida online në 200 agroturizmet shqiptare Fq.5
- Punonjësit në ish-ndërmarrjet bujqësore, Manjani: Njohje e periudhave të sigurimit pa pengesa Fq.6
- Kalendari bujqësor, muaji shkurt 2025 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

FINANCIM

Banka Shqiptare e Zhvillimit, Ibrahimaj konsultime me bankat



Faqe 3

Mata: Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, rreth 87 milionë dollarë në mbi 37 projekte në arsim

Bashkëdrejtori ekzekutiv i Fondit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, (AADF), Martin Mata theksoi sot rëndësinë e investimit në fushën e arsimit, si faktor kryesor në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Mata, në takimin e zhvilluar në Institutin "Harry Fultz", në Tiranë, bëri të ditur se AADF ka angazhuar në fushën e arsimit një portofol prej 87 milionë dollarësh në mbi 37 projekte.

Në rreth 140 milionë dollarë të angazhuara nga AADF, mbi 87 milionë dollarë janë angazhuar në fushën e arsimit. Mbi 37 projekte që kanë marrë jetë, tha ai.

Mata renditi disa nga projektet që po zbatohen që nisin me laboratorët inteligjentë në shkolla, TUMO, Junior Achievement, Akademia e Kodimit, Shkolla e Drejtorëve, dhe që tashmë shkohet një hap më tej në segmentin universitar.

studentë në SHBA, proces që vijon ende, por që ka kosto të lartë dhe numër të kufizuar studentësh që përfitojnë, theksoi Mata.

Ndaj vuri në dukje ai, zhvilluam një program që është quajtur "Fondi Kombëtar i Bursave", brenda AADF, për hapjen e një tjetër dërrë të madhe të formimit akademik e profesional, Institutit të Teknologjisë Rochester (RIT), i cili renditet ndër universitetet më të mira në SHBA.

"Vumë disa kushte që ne besojmë janë kolona themelore për të rritur cilësinë e arsimit në Shqipëri dhe ato kushte janë dhe do të mbeten që në Shqipëri të ketë mundësi të vijnë emra si RIT, të certifikuar, të njohur e listuar në universitetet më të mira të botës", u shpreh Mata.

Ai siguroi se AADF do të zhvillojë një proces konkurrues të shëndetshëm, ku me qindra studentë, në vitet që vijnë do të marrin deri në 70 % të bursës së tyre të mbuluar nga AADF.

"Është detyra, misioni ynë të sjellim në Shqipëri modele të tilla dhe të sigurohemi që çdo dollar që harxhohet sot në arsim, të kthehet mbrapsht deri në 10 herë në 20 vitet e ardhshme", deklaroi ai.



"Ne shpesh themi se nëse do të shikosh Shqipërinë e pas 20 viteve, shiko se si edukohen fëmijët sot. Ndaj dhe kemi zhvilluar një portofol. Numrat kanë rëndësinë e vet.

"Kishte mbetur ky segment i paplotësuar. Duke u përpjekur të gjejmë rolin tonë në këtë segment të jetës arsimore studentore në Shqipëri e filluam fillimisht duke dërguar

Kalojnë online edhe katër shërbime të reja doganore

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave njofton se në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ka realizuar me sukses testimet në katër shërbime të reja do-

lejon që mallrat shqiptare të eksportohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me qëllim që t'u nënshtrohen operacioneve përpunuese dhe produktet që dalin si rezultat i këtyre op-


jashtim nga rregulli i kompetencës territoriale" përdoret në ato raste kur operatorët ekonomikë për arsye të ndryshme të argumentuara dhe të dokumentuara kërkojnë kryerjen e formaliteteve doganore në degët doganore të ndryshme nga dega doganore kompetente për territorin ku është vendosur aktiviteti (çdo vit apo periudha të vitit).

3. Kërkesë për shtesa/ndryshime në Autorizimin e Regjimit të Magazinës Doganore

Magazinimi i Përkohshëm është statusi i mallrave shqiptare nga momenti që ato paraqiten në doganë deri në caktimin e një destinacioni doganor.

4. Kërkesë për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga një mbajtës tek një tjetër të autorizimit për RPA

Sipas kërkesave të ndryshme që mund t'i paraqiten një Operatori Ekonomik gjatë procesit të punës mund t'i lind nevoja e transferimit të mallrave nën RPA nga një mbajtës i Autorizimit të RPA në një mbajtës tjetër të Autorizimit të RPA.



ganore të cilat do të ofrohen nga sot online nëpërmjet platformës e-Albania.

Shërbimet e reja që do të ofrohen online janë:

1. Kërkesat për shtesa apo ndryshime në Autorizimin e Regjimit të Përpunimit Pasiv Regjimi i përpunimit pasiv

eracioneve të vendosen në qarkullim të lirë me përfshirje të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit. Për të aplikuar online.

2. Aplikim për përjashtim nga rregulli i kompetencës territoriale

Shërbimi "Aplikim për për-

Plani i Rritjes, BE njofton lëvrimin e rreth 60 milionë eurove brenda marsit

Shqipëria do të marrë deri në fund të muajit mars pjesën e financimit që lëvrohet automatikisht nga Plani i Rritjes i Bashkimit Europian.

Delegacioni i BE-së në Tiranë iu përgjigj interesimit të RTSH-së për afatet e lëvrimin të këtyre fondeve, duke kujtuar se "Plani i Rritjes përfaqëson një ofertë gjithëpërfshirëse të BE-së për Ballkanin Perëndimor për të nxitur progresin dhe për të reduktuar hendekun e zhvillimit midis Shqipërisë dhe BE-së".

"Qëllimi i tij është të plotësojë dhe përshpejtojë procesin e anëtarësimit në BE. Plani mbështetet nga një instrument i ri financimi i bazuar në performancë, Faciliteti për Reforma dhe Rritje," thuhet në përgjigjet e delegacionit europian.

Në përgjigjen zyrtar, fondet e quajtura "Brenda Planit Parafinancim" dhe përkatësisht 7 për qind ose 61 milionë e 922 milionë euro që i takojnë Shqipërisë, pritet të realizohen brenda muajit mars.

"Ashtu si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe pas miratimit të Agjendës së Reformës, Shqipëria do të marrë 7 për qind

parafinancim. Shqipëria është në proces të përfundimit të miratimit të brendshëm të Marrëveshjes së

dhe Malin e Zi - kap shumën prej 6 miliardë eurosh dhe mbulon periudhën 2024-2027.



Facilitetit dhe Marrëveshjes së Huasë, duke përfshirë ratifikimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

Jemi në kontakt të vazhdueshëm me Qeverinë e Shqipërisë për të finalizuar parafinancimin që pritet deri në fund të marsit 2025," sqaron delegacioni europian në Shqipëri.

Paketa e përgjithshme për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor - Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën

Brenda saj, një tjetër kushtëzim lidhet me veprimin e vetë vendeve për të përmbushur përfitimin e 2 miliardë eurove grante nga BE-ja pa kthim, ndërsa pjesa tjetër në formën e kredive të favorshme.

Siç u tha në paraqitjen e parë të këtij plani, vendeve të rajonit u është thënë qartë se shumica do t'u shpërndahet vendeve të tjera nëse nuk shihen rezultate në kryerjen e reformave pas një ose dy vitesh.

Komisioni European mbështet AZHBR-në për përmirësimin e teknikave të auditimit

Stafi i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ka përmbyllur me sukses një cikël tjetër trajnimesh, në përvetësimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, në drejtim të teknikave të auditimit në sistemet IT.

Trajnimi për përgatitjen dhe avancimin e auditimit të brendshëm në sistemet IT të AZHBR, ka në fokus menaxhimin dhe kontrollin e fondeve dhe të dhënave.

AZHBR njofton se, "ky trajnim, u mbështet nga Technical Assistance and Information Exchange Instrument of the European Commission (TAIEX) dhe është realizuar me ekspertë të agjencive homologe nga Rumania, Kroacia dhe Polonia, me synim përgatitjen e stafit të auditimit për të realizuar auditime të brendshme të sistemeve të IT, duke

vlerësuar risqet dhe masat kontrolluese përkatëse".

Në fokus të trajnimit ishte përmirësimi i praktikave të vetëvlerësimit dhe forcimit të kapaciteteve të audituesve për të vlerësuar masat e kontrollit të sistemeve, duke siguruar mbrojtjen nga risqet të mundshme.

"Bashkëpunimi me ekspertët ndërkombëtarë ka për qëllim të sigurojë auditim të besueshëm dhe efikas për sistemet që mbështesin menaxhimin e fondeve dhe proceseve të prokurimit publik, duke promovuar transparencën dhe qeverisjen e mirë", bën të ditur AZHBR.



Rriten çmimet në treg, produktet josezonale me kosto më të lartë

Rritja e çmimeve të disa produkteve josezonale kandiduar në uljen e numrit të blerësve.

Jemi në mesin e shkurtit dhe çmimet e produkteve agro-ushqimore mbeten të larta. Kjo ka bërë që shumë qytetarë të kufizojnë blerjet e tyre, duke u fokusuar vetëm

tek produktet e nevojshme për përditshmërinë.

"Marrim më pak fruta, te gjitha nuk kemi mundësi, marrim ato më të domosdoshme".

"Marrim vetëm ato të stinës, të tjerat nuk i përballojmë". Produktet që nuk janë të Kukësit janë më çmime shumë më të

larta se ato të vendit", shpreh qytetarët.

Më së shumti, rritjen më të madhe e kanë pësuar produktet josezonale, si perimet. Këto produkte arrijnë në Kukës me çmime të larta për shkak të kostove të transportit dhe prodhimit në qytete të tjera.

FINANÇIM

BANKA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT

FINANÇIMI 250 MLN EURO NË BUJQËSI, RRAPAJ: DO T'I NDIHMOJË SHUMË FERMERËT, BANKAT FRIKËSOHEN TË JAPIN KREDI, PASI SHIHET SEKTOR ME RISK

Qeveria ka prezantuar një instrument të ri bankar me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh, për të lehtësuar aksesin në kredi për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Lidhur me këtë propozim, kryetari i Këshillit të Agrobiznesit, Agim Rrapaj u shpreh se kjo është një nismë që do t'i vijë në ndihmë fermerëve

Qeveria ka prezantuar një instrument të ri bankar me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh për të lehtësuar aksesin në kredi për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Lidhur me këtë propozim, kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Agim Rrapaj, në një lidhje skype ditën e sotme në emisionin 'Sot Live në Shqipëri', në Report Tv u shpreh se kjo është një nismë që do t'i vijë në ndihmë fermerëve.

'Po do t'i ndihmojë shumë, është një hap në drejtim e

duhur, duhet të ishte bërë më herët por edhe tani është momenti i përshtatshëm që ata të kenë mundësi që të marrin kredi me kushte lehtësuese. Banka me këtë veprim plotësoi një nga kërkesat e fermerëve për të mundësuar financimin e projekteve të tyre. Nevojat e tyre për financim janë të mëdha, por s'ka qenë mundësit ato që të mund të plotësonin të gjitha kërkesat e nevojshme që ka sektori', tha ai.

Rrapaj tha se një nga arsyet që bankat nuk japin kredi për



NGA TIRANA

'HAP I VONUAR, POR MOMENTI I DUHUR PËR TË NDIHMUAR FERM'

sektorin e bujqësisë është se ky shihet si një sektor me risk.

'Bankat frikësohen sepse ato kanë treg dhe duke pasur treg për të dhënë kredi nuk futen në sektorin e bujqësisë dhe ekonomisë së ushqimit dhe duke qenë një sektor me risk, bankat nuk rrezikojnë që të japin kredi në këtë sektor. Pastaj ka të bëjë me burokracinë e madhe që është për marrjen e një kredi për fermerët për kushtet që ata kanë dhe për projektet e tyre', tha ai.

Teksa u ndal tek sektorët

që kanë më tepër nevojë për mbështetje, ai veçoi bujqësinë dhe blegtorinë.

'Blegtoria kërkon një vëmendje të posaçme për të stabilizuar një program të plotë dhe afatgjatë sepse është një sektor me rëndësi. Pa blegtorinë s'mund ta mbajmë gjallë në zonat rurale nuk shkohet vetëm për malet por edhe për ushqimet që kanë këto vende. Edhe bujqësia pavarisht problemeve dhe vështirësive që ka, është një sektor jetik i zhvillimit ekonomik të vendit', tha ai.

Banka Shqiptare e Zhvillimit, Ibrahimaj konsultime me bankat

Qeveria ka prezantuar një instrument të ri bankar me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh për të lehtësuar aksesin në kredi për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Lidhur me këtë propozim, kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Agim Rrapaj, u shpreh se kjo është një nismë që do t'i vijë në ndihmë fermerëve

Ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj zhvilloi një takim me përfaqësues të institucioneve bankare, në kuadër të konsultimeve për ngritjen e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, përmes së cilës synohet mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë mikrondërmarrjet dhe startup-et si edhe projekteve zhvillimore që lidhen me përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale, me fokus të veçantë tek investimet e gjelbra.

Qeveria prezantoi së fundmi projektligjin për ngritjen e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, e ngjashme me bankat apo institucionet kombëtare promovuese që funksionojnë në Bashkimin Evropian, me synim kryesor nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, përmes lehtësimit të qasjes në financë të sektorëve të nënfinancuar të ekonomisë.

Ministrja theksoi se ky bashkëbisedim është thelbësor për të siguruar që ky institucion i ri financiar të ofrojë instrumente efektive për nxitjen e kreditimit dhe zhvillimit ekonomik.

'Krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit është një hap i

rëndësishëm për forcimin e klimës së biznesit në vend dhe për përafrimin e Shqipërisë me modelet më të avancuara evropiane, duke i hapur rrugën

byera, duke synuar një qasje plotësuese ndaj financimeve që ofrohen nga operatorët tregtarë financiarë.

Në projektligjin e dalë për



një ekonomie më të fortë, konkurruese dhe të zhvilluar", deklaroi Ibrahimaj.

Arsyetimi kryesor ekonomik për ekzistencën e një institucioni të tillë bazohet në faktin se operimi nën potencial apo dështimet e tregut mund të çojnë në mungesë financimi dhe investimesh që, si rezultat, sjellin një rritje më të ngadaltë sesa ajo që do të ishte ekonomikisht e dobishme apo e synuar.

Këto institucione ndërhyjnë në ato segmente që mbeten të nënfinancuara apo të nënshër-

konsultim publik thuhet se veprimtaria e tyre ushtrohet në përputhje me legjisllacionin për ndihmën shtetërore dhe pa shkaktuar ndikim të padrejtë në konkurrencë.

Veprimtaria e Bankës së Zhvillimit do të fokusohet në fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, startup-ëve, promovimin e eksporteve, mbështetjen e projekteve publike në nivel qendror dhe vendor me rëndësi për zhvillimin ekonomik, apo dhe zhvillimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale.

Financimi 250 mln euro në bujqësi, Rrapaj në Report Tv: Mbi 100 mijë përfitues! Çoçoli: Njihen vitet e punës edhe pa dokumente për fermerët që kanë punuar në kooperativa

Qeveria ka prezantuar një instrument të ri bankar me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh për të lehtësuar aksesin në kredi për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Lidhur me këtë, kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Agim Rrapaj, u shpreh se janë mbi 100 mijë fermerë do të përfitojnë nga kredia e butë

Qeveria ka prezantuar një instrument të ri bankar me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh, për të lehtësuar aksesin në kredi për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Lidhur me këtë, kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Agim Rrapaj, i ftuar në emisionin 'Studio Live', në Report Tv u shpreh se janë mbi 100 mijë fermerë do të përfitojnë nga kredia e butë.

'Mbështetja e Bujqësisë nga Banka e Shqipërisë është një arritje e rëndësishme. Si do të përfitojnë këta? Ka një politikë të re sa i përket grupimeve, po jepen me interes të ulët nuk është dhënë asnjëherë me kaq interes të ulët kreditit. Në skemën që u bë vjet u vu kriteri që grupimet do të mbështeten 100% dhe kjo bëri që brenda një 2 muajshi u bënë 306 grupime. Do të ketë kombinime dhe nuk humbet interesi për grupimet, prandaj fermerët të ndjekin shembullin që është krijuar. Këto grupe duhet që të bëhen të qëndrueshme dhe të kenë mundësi që të thithin. Mbi 100 mijë fermerë do të përfitojnë nga kredia e butë', tha ai.

Për ekspertin e Ekonomisë Fatos Çoçoli, 250 milionë euro kredi e butë do të jenë vetëm

për ndërmarrjet të mesme dhe të vogla.

'Më në fund shteti po kthen kokën e dhe nga bujqësia. Kemi krahas projektit të Bankës së Zhvillimit kemi edhe një fond rreth 250 milionë euro hua të buta që do të jepen për ndërmarrjet mikro të mesme dhe të

e pensioneve të fermerëve. Ai tha se janë 29 mijë përfitues, të cilët edhe pse kanë punuar në kooperativa dhe nuk kanë pasur dokumente që të vërtetonin vitet e punës, tashmë ato vite pune do ti njihen.

'Janë 29 mijë përfitues të amnistisë. Sepse ata që kanë



vogla. Sektori bujqësor do të ketë përparësi, ky fond do të jepet çdo vit. Është fjala për të bërë një biznes që mund të quhet i vogël dhe i mesëm, ata sipërmarrës të grumbullimit, të bujtinave. Do jenë hua të leverdishme për fermerin por jo për atë fermerë që ka një aktivitet mbijetese', tha ai.

Çoçoli foli edhe për skemën

qenë në kooperativa bujqësore nuk kanë dokumente që të vërtetonin që ka punuar në në kooperativ dhe deri tani shteti thoshte hidheni në gjyq dhe ata nuk e bënin, sepse e dinin se sa kohë do t'u duhej, tani shteti thotë të gjithë ju jeni të amnistuar, ju do t'ju njihen këto si vite pune', tha ai.

INFORMACIONE

Siguria ushqimore, Denaj: Kush abuzon, do të shkojë për ndjekje penale

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj deklaroi se në drejtim të sigurisë ushqimore është bërë një punë, sipas saj, kolosale.

Në një intervistë në media, Denaj u ndal dhe te raportimet disa javë më parë për mbingarkesë me pesticide të mandarinave.

“Nga 924 ngarkesa me mandarina, vetëm katër prej tyre janë kthyer”, deklaroi Denaj.

Sipas saj, sipërmarrësit vetë duhet të kryejnë kontrollin e ngarkesave, pasi janë ata vetë që shpërndajnë produktin në vende të tjera.

Ministrja tha se në sistemin e raportimeve bën pjesë dhe Shqipëria, e cila ka gjetur dhe ka njoftuar ngarkesa problematike, nga fqinji ynë jugor, Greqia.

Ajo theksoi se krahas inspektimeve në terren, duhet të rritet edhe ndërgjegjësimi i fermerëve për ruajtjen e sigurisë ushqimore.

Sipas ministres Denaj, janë marrë të gjitha masat dhe do të ketë ndëshkime penale për cilindo nga fermerët i cili kapet duke abuzuar me sigurinë ushqimore.

“Për vitin e kaluar janë kryer 111 mijë inspektime dhe kjo është mjaftueshëm për të ngjallur frikën. Unë nuk besoj te frika, para se të besoj te ndërgjegjësimi. Ne kemi sot autokontrollin dhe kështu është dhe në Evropë. Është ndërgjegjësimi i fermerëve se çfarë pesticidesh përdorin. Agronomi e kontrollon. Nuk

mundesh që për shtatë ferma që mund të kenë përdorur një produkt të tillë të hedhësh të gjithë produktet e 924 ngarkesave në kosh të plehrave”, tha Denaj.

“Sigurisht, janë për ndjekje penale. Këto janë masa të marra brenda dy ditëve, kur ka ndodhur rasti. Duhet që fermeri të kuptojë që i ka ikur koha përdorimit të çdo produkti që nuk është i lejuar dhe nuk



është i certifikuar. Përpjekja për të përmirësuar të gjithë gjurmueshmërinë sot është fakt. Rasti ne nuk na tremb, se siç na raportojnë, edhe ne raportojmë. Të çojmë deri në ndjekje penale, të bëjmë shembull këdo që përdor produkte të cilat janë të palejuara. Nuk mundet që me katër apo pesë raste të përgjithësojmë të gjithë fermerët”, tha ajo.

Ministrja informoi se do të ketë rregullim të inspektimeve për ta bërë të plotë procesin duke zgjeruar gamën e inspektimit dhe ulur numrin.

“Besoj në korrik hyn në fuqi ligji “Për inspektoratet”. AKU në funksionet që janë sot nuk do ekzistojë. Ne kemi bërë gati strukturën dhe Inspektorati i Peshkimit së bashku me atë të Mbrojtjes së Bimëve dhe të Veterinarisë do bashkohen në një inspektorat. Synojmë të bëjmë një modul risku, që kur i shkohet një biznesi i shkohet për shumë gjëra dhe bën një kon-

troll të sinqertë në raport me biznesit, dhe jo herë pas here trokitje. Nëse duhet të zhvillojmë një bujqësi duhet të rritemi në shkallë, të lidhemi në kontrata, në subvencione, në skemë fiskale të rishikuar. Janë të gjithë aktorët që duhet t'i shërbejnë një ekonomie bujqësore ku ne të mos diskutojmë më ekzistencën e kontratave”, tha më tej ministrja.

Denaj u ndal edhe gripi i shpendëve, duke siguruar se situata tashmë është nën kontroll dhe se nuk ka vend për shqetësim.

Prodhimi i fidanëve bujqësorë, Balluku: Detyrim mbështetja për këtë sektor të rëndësishëm

Zëvendëskryeministrja Belinda Balluku, njëherësh ministre Infrastruktursë dhe Energjisë, ishte në fshatin Allkaj në Lushnjë në fidanishten “Agro Sina”, “ku përgatiten fidanë për produkte të ndryshme bujqësore që tregtohen

bashkëpunon edhe me shumë kompani nga vende evropiane si Spanja, Franca, Bullgaria.

Ai tha se, ka investuar në kultivimin e fidanëve në serra me teknologji të lartë, me një strukturë që mbështetet në sistemin novativ të klimës dhe

fidanishtes më të njohur në bashkinë Lushnjë.

“Më këtë biznes merrem prej rreth 13 vitesh. Kemi përdorur metoda shartimi që bimët të prodhojmë më shumë. Kemi një ngarkesë të madhe. 1 milion e gjysmë fidanë për t'u shartuar deri në prill”, tha fermeri.

“Ne synojmë që sistemi rrënjor i bimëve të jetë i fuqishëm. Shartesat janë të tilla që i rezistojnë më shumë kripërave, pasi Myzeqeja ka shumë kripëra”, shtoi ai.

Më tej ministrja theksoi se “është detyrë për të gjithë ne që të mbështesim këtë sektor kaq të rëndësishëm në bujqësi duke njohur vështirësitë, por nga ana tjetër duke njohur edhe të gjitha përpjekjet që ju bëni edhe në emër të fermerëve të Myzeqesë”.

Kjo serrë ka një rëndësi strategjike në këtë zonë, e cila dallohet për aktivitet të lartë bujqësor, duke mundësuar edhe furnizimin me fidanë të fermerëve përreth.



kudo nëpër Shqipëri”.

Fermeri Beshir Sina së bashku me të birin e tij, Marjolin, thanë se merren me këtë biznes prej 13 vitesh dhe punon jo vetëm për brenda vendit por

ujitjes, për matjen e parametereve të kushteve të brendshme.

Balluku e cilësoi fidanishten “Agro Sina” një nga pikat e shpërndarjes së farës dhe të

Denaj: Të rinjtë po e kthejnë traditën në mundësi për vizionin “Bujqësia 2030”

Me pasionin për punën dhe traditën shumëvjeçare të zonës për kultivimin e bimëve medicinale, Ervini në Malësinë e Madhe, kultivon në 15 hektarë sherebelë, lavandër dhe trumzë për eksport.

Me biznesin e tij, ai po kontribuon në fuqizimin e ekonomisë rurale, duke rritur vlerën e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Ministrja e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ndau në rrjete sociale historinë e tij, teksa vuri në dukje se, “prodhimet “Made in Albania”, po bëhet një markë e fortë

falë të rinjve.

“Të rinjtë besojnë në potencialin e tyre dhe po e kthejnë traditën në mundësi për vizionin “Bujqësia 2030”, u shpreh Denaj.

Industria e bimëve mjekësore dhe aromatike ka shënuar një trend në rritje vitet e fundit në vendin tonë, duke u kthyer në një burim të ardhurash për mijëra familje. Ndërsa gjithnjë e më tepër vihet re një prezencë të këtyre bimëve në tregun botëror të kësaj industrie.

Rritja e eksporteve të këtyre bimëve është një ndër prioritetet e politikave të Ministrisë

së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Shqipëria ka qindra bimë mjekësore dhe aromatike që rriten kryesisht në zonat malore të vendit, ndërkohë ndër më të njohurat mund të përmendim sherbelën, balsamin, rignonin, boronicën, qershinë e egër, livandën, trumzën, bimën e makthit, hithrën, cianin, trëndafilin e egër dhe shtogun.

Këto lloje bimësh gjejnë përdorim në industrinë farmaceutike, ushqimore dhe kozmetike, ndërsa procesi i përgatitjes së tyre kalon në faza të ndryshme.

Dhuli: Brenda vitit hartohet projektligji për realizimin e Censit të Bujqësisë

Drejtorja e përgjithshme e Institutit të Statistikave (INSTAT) Elsa Dhuli bëri të ditur se brenda këtij viti do të hartohet projektligji për realizimin e Censit të Bujqësisë.

Gjatë diskutimit në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat mbi planin vjetor 2025 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2022-2026, Dhuli informoi se po rishikohet strategjia për organizimin e këtij plani, si dhe buxheti.

“Në kuadër të përgatitjeve për Censin e Bujqësisë, jemi në proces të miratimit të projektligjit. Po rishikohet strategjia e organizimit të këtij Censi, planit të aktiviteteve dhe buxhetit”, u shpreh Dhuli.

Njëkohësisht ajo informoi se po finalizohet edhe pyetësori në konsultim të vazhdueshëm me asistencën teknike.

“Po finalizohet korniza

metodologjike në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural, duke marrë në

European, FAO apo Institutin”, u shpreh Dhuli.

Censi i Bujqësisë do të sigurojë informacione mbi



konsideratë jo vetëm burimet administrative, por edhe rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave të realizuar në 2023. Ngritja e sistemit të teknologjisë së informacionit për mbledhjen, monitorimin dhe analizën e të dhënave, në bashkëpunim me Komisionin

module të veçanta, në të gjitha fermat bujqësore që kanë të bëjnë me: ujatjen, praktikën e menaxhimit të tokës, makineritë dhe pajisjet, pemëtarinë si dhe të dhëna për strukturën e bujqësisë, veçanërisht për njësitë e vogla administrative.

Mungesë tregu për bimët mjekësore në Kukës, grumbulluesit kërkojnë mbështetje

Mbarimi i punës për mbledhjen e bimëve medicinale nga banorët që jetojnë në njësitë administrative të Kukësit përfundon me dëllinjen në muajin janar. Ndërkohë fillon sfida e grumbulluesve të cilët në këtë periudhë po hasin vështirësi të shumtë për shkak të mungesës së tregut.

Gazmend Koldashi një nga grumbulluesit e bimëve mjekësore, tregon se industria e grumbullimit të bimëve është goditur dhe nga rënia e euros. Ata kërkojnë më shumë mbështetje nga Ministria e Bujqësisë në këtë periudhë ku të gjithë bimët i kanë të mbetura stok.

“Shpresojmë që këtë vit të ketë ritëm më të lartë të grumbullimit të bimëve dhe të shitjeve të tyre. Nga Ministria e Bujqësisë kërkojmë të kemi subvencione, të investohet në dhoma frigoriferike”, tha Koldashi.

E gjithë puna e grumbul-

limit të bimëve medicinale nis me bimën e agulices e përfundon me mbledhjen e dellisë. Të mbledhura në Bjeshkë e te veçuara për cilësinë nga të ardhurat që marrin me shitjen e bimëve shumë familje sigurojnë jetesën.



“Paketa e Maleve”, zhvillim për zonat malore - Dervishi: Vëmendje t’i kushtohet edhe ndërtimeve në zonat e mbrojtura

Kryetari i Shoqatës së Restoranteve dhe Bujtinave Shqiptare, Kujtim Dervishi, mendon se “Paketa e Maleve” do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të zonave malore. Gjithashtu, ai sugjeron që një vëmendje e veçantë ti kushtohet edhe investimeve në zonat e mbrojtura.

Projektligji për “Paketën e Maleve”, i miratuar të enjten në mbledhjen e qeverisë, do të ketë një efekt pozitiv në zh-

villimin ekonomik dhe social të zonave malore. I ftuar në Scan Live, Kryetar i Shoqatës së Restoranteve dhe Bujtinave Shqiptare, Kujtim Dervishi, deklaroi se lehtësitë që ofrohen në këtë paketë do të bëjnë që emigrantët të në Shqipëri, sjellin jo vetëm kapitalin, por edhe njohuritë që kanë fituar jashtë vendit.

Gjithashtu, sipas z. Dervishi në hartën e investimeve duhet të përfshihen edhe zonat e mbrojtura, por me kushtin që të respektohen dhe të mbrohet natyra.

Ndër të tjera, projektligji parashikon kalimin e pronësisë shtetërore në atë private me një tarifë simbolike prej 1 euro, por certifikata e pronësisë merret pasi realizohet ndërtimi i planifikuar. Nëse për një periudhë 3-vjeçare nuk fillon ndërtimi, atëherë Ministria e Ekonomisë ka të drejtën ta zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Projektligji i miratuar në mbledhjen e qeverisë, parashikon shpalljen e zonave malore me përparësi zhvillimi si dhe zhvillimin e pasurive shtetërore të poseduara pa titull pronësie nga subjektet private në këto zona, në harmoni me rregullat e legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Shiten me 1 euro tokat pa tapi/ Çfarë përmban “paketa e maleve”? - Kush investon përjashtohet nga 4 taksa kryesore për 10 vjet!

Qeveria ka lançuar “Paketën e Maleve” e cila synon të tërheqë investime për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë në ato zona malore me përparësi të veçantë me qëllim rimëkëmbjen ekonomike, nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shfrytëzimin me eficiencë të burimeve të natyrës.

Drafti në fjalë i hap dritën jeshilë kalimit të pronësisë përmes shitjes me tarifën simbolike 1 euro të këtyre pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat rezultojnë të jenë në posedim faktik të poseduesve jopronarë.

Në këtë rast, posedues jopronarë, quhen ata individë të cilët ushtrojnë posedim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë prej të paktën 10 vitesh mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore, duke e përdorur atë sikur të ishte ai pronari i saj.

Për këtë, subjekti paraqet dokumentacion provues, por megjithatë mungesa e dokumentacionit nuk pengon procedurën administrative për

njohjen e tij si “posedues jopronar” dhe merret i mirëqenë deklarimi i subjektit për sa kohë nuk paraqiten prova nga

të sipërfaqes së poseduar, të hartuar nga një ekspert gjeodet i licencuar.

Dhe më pas institucionet



SHITEN ME 1 EURO TOKAT PA TAPI/ ÇFARË PËRMBAN “PAKETA E MALEVE”? KUSH INVESTON PËRJASHTOHET NGA 4 TAKSA KRYESORE PËR 10 VJET

të tretët për të kundërtën gjatë afishimit publik dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Po ashtu, do të konsiderohen posedues jopronarë edhe ata persona fizikë që nuk e përdorin pasurinë, por vërtetojnë lidhjen e tyre me pasurinë, për të cilën nuk janë pajisur me titull pronësie, sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkojnë ta zhvillojnë atë nëpërmjet një investimi.

Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, që shpall zonën e zhvillimit, subjektet duhet të paraqesin kërkesë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për njohjen si posedues jopronarë, të shoqëruar me plan rievimi

vendore verifikojnë kërkesën për miratimin apo jo të saj. Në rast miratimi, procedura kalon në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, për marrjen e lejes së zhvillimit. Dhe në fund bëhet kërkesa për blerje pranë ministrisë përgjegjëse dhe kontrata e shitjes.

Subjektet, që përfitojnë pronësinë mbi sipërfaqet sipas këtij ligji e që realizojnë projektin dhe ushtrojnë aktivitetin e deklaruar prej tyre, përfitojnë për një periudhë 10-vjeçare: përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë; përjashtim nga taksa e pasurive të paluajtshme; përjashtim nga TVSH-ja; përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat.



“PAKETA E MALEVE”, ZHVILLIM PËR ZONAT MALORE

DERVISHI: VËMENDJE TI KUSHTOHET EDHE NDËRTIMEVE NË ZONAT E MBROJTURA

Qepët mbeten pa shitur në Maliq, fermerët hedhin prodhimin për shkak të mungesës së tregut

Fermerët e fshatit Zvirinë në Maliq janë përballur sërish me vështirësi në shitjen e prodhimit të qepës, duke i detyruar ata ta hedhin atë.

Mungesa e tregut dhe çmimi i ulët kanë bërë që munda i një viti të shkojë dëm, duke sjellë humbje të mëdha për banorët e zonës.

“Shumë rrallë vijnë tregtarët por edhe ata që vijnë e dua për 10 lekë të reja. Ne nuk mund ta japim kaq pak, se ajo ka kosto 30 leke. Ne çfarë do fitojmë” shprehet një prej fermerëve.

Ndërsa një tjetër që merret me kultivimin e qepës, u shpreh për RTSH-në, se kanali është mbushur me qep që e kanë hedhur fshatarët.

“Nuk shiten, është shumë e ulët kostoja dhe po na qëndrojnë stok.

Situata është shumë keq, thotë një tjetër banor i zonës.

“Po punojmë gjithë beharin dhe nuk po marrim gjë. Ka shpenzime të mëdha. Tregtarët që vijnë e duan lirë sepse ata e marrin nga jashtë.

Megjithatë, pavarësisht sit-

uatës së vështirë, fermerët nuk e humbasin shpresën dhe kanë vendosur të mbjellin përsëri qepë, me besimin se tregu do të përmirësohet.

“Pavarësisht kësaj, banorët vetëm mbjellin qep. Pavarësisht se ato nuk janë shitur sërish shpresojnë”

Fusha e Maliqit mbetet një nga zonat kryesore të kultivimit të qepës, me 850 hektarë të mbjellë vitin e kaluar, por sfidat e tregimit vazhdojnë të rëndojnë mbi prodhuesit vendas.

Shitja e agrumeve nën kosto - Fermerët në Lushnjë e Fier, po i zëvendësojnë ato duke mbjellë ullinj

Momentalisht është koha e mbjelljes së fidanëve dhe fermerët po kryejnë mbjelljet e reja. Në Kolonjë të Lushnjës dhe Vajkan të Fierit kërkesat për fidanët e ullirit kanë trefishuar çmimin. Kjo pasi ka kërkesë për blerjen e tyre, pasi fermerët po heqin dorë nga agrumet për shkak të shitjes nën kosto të prodhimit dhe stokut të krijuar.

“Ulliri kërkohet më shumë sivjet, janë shtuar shumë kërkesat dhe nuk ka ullinj”, u shpreh fermeri Qani Dërka.

Fermerët pohojnë se gjatë 5 viteve të fundit nuk ka pasur kërkesa për mbjelljen e ullinjve, ndaj ata kanë prodhuar pak fidanë. Këtë vit gjithçka ka ndryshuar, është rritur kërkesa dhe çmimi.

“Kërkojnë ullinj koronet ndërsa mandarinat i shitëm me

250 lek”, u shpreh Aris Alla, një tjetër fermer.

Fidanët prodhohen në kushte serre nga vet fermerët të cilët ankohen se nuk gjejnë dot punëtorë. Sipas tyre ata punojnë familjarisht pasi të rinjtë kanë emigruar duke detyruar moshat e treta të merren me bujqësi. Fidanët e ullirit kërkohen të mbillen me shumicë në qarqet e Tiranës, Beratit, Durrësit dhe Shkodrës.

Balluku: Produktet shqiptare, drejt tregjeve të SHBA

Zëvendëskryeministrja, Belinda Balluku, njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë vizitoi në Divjakë fabrikën e përpunimit të qumështit “Extra Milk”, produktet e të cilës tregtohen sot edhe në Shtetet e Bashkuara.

Zëvendëskryeministrja theksoi rëndësinë e këtyre industrive për sektorin e bujqësisë.

“Nëse do të ndalonte vetëm tek bujqësia, nuk do të kishte rezultatin e duhur, pasi cilësia e parë dhe e dytë mund të tregtohej, ndërsa cilësitë e tjera mund të përpunohen dhe në këtë mënyrë mund të kemi produkte vendase që eksportohen”, u shpreh zëvendëskryeministrja Balluku.

Po ashtu vuri theksin edhe te sektori i turizmit, pasi sipas saj, zhvillimi i turizmit nxit edhe rritjen e prodhimeve bujqësore.

“Të gjitha këto së bashku mund të përdoren tek sektori i turizmit në vend. Pasi turistët, kur vijnë, nuk vijnë për të konsumuar produktet e importuara,

por dëshirojnë të konsumojnë produktet shqiptare. Në këtë mënyrë, industria e agropërpunimit ndihmon fermerët duke shfrytëzuar kapacitetet e

dhimet e saj edhe në Shtetet e Bashkuara.

“Kam marrë një mision, kam vendosur të promovoj njerëzit punëtorë të qarkut të



prodhimit. Industria agropërpunuese është një hallkë kyçe për rritjen e vlerës së prodhimeve bujqësore vendase”, tha Balluku.

Kompania “Extra Milk” jo vetëm është konsoliduar në tregun tonë, përmes tregimit të produkteve cilësore e të veçanta, por i eksporton pro-

Fierit që njihet edhe si hambari i Shqipërisë”, deklaroi Balluku.

Kompania bashkëpunon me afro 1800 familje fermerësh, në Divjakë e më gjerë, ndërsa planet janë që të zgjerohet edhe më tej, duke shtuar prodhimin dhe llojet e produkteve.

Kumbaro: Treg i ri në Gjirokastrë, mbështetje fermerëve dhe produkteve vendase

Gjirokastrës do t'i shtohet një treg për tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, një tjetër aset që nxit ekonominë dhe turizmin në këtë zonë. Ministrija e Turizmit dhe

fondit të qeverisë shqiptare për projektin e rivitalizimit të tregjeve tradicionale në 6 bashki, përmes një akti të ri normativ.

“Me një ofertë të pasur të

mbështet fermerët dhe garanton treg për ta, duke promovuar në të njëjtën kohë produktin vendas, atë lokal duke u kthyer edhe në një atraksion për zonën”, tha Kumbaro.

Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të 21 dhjetorit 2024 u miratua akti normativ për financimin e rivitalizimit të 6 tregjeve ushqimore në Shkodër, Pukë, Vlorë, Durrës, Divjakë dhe Gjirokastrë.

Qeveria shqiptare dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbështesin rivitalizimin e tregjeve tradicionale, të cilat do të shërbejnë për garantimin e tregimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, rritjen e fuqisë negociuese të fermerëve në çmime, si dhe promovimin e produkteve bujqësore dhe turistike të zonës.



Mjedisit, Mirela Kumbaro tha se ky treg do të ndërtohet falë

produkteve bujqësore e blegtorale ky investim në Gjirokastrë

Punonjësit në ish-ndërmarrjet bujqësore, Manjani: Njohje e periudhave të sigurimit pa pengesa

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave hapi rrugën kalimit të seancë plenare të ndryshimeve ligjore të propozuara nga qeveria, për njohjen pa pengesa të periudhës së sigurimit për punonjësit e ish-ndërmarrjeve bujqësore.

Zv/ministria Manjani ishte sot e pranishme në Komisionin për Ekonominë dhe Financat ku u diskutuan ndryshimet ligjore të propozuara nga qeveria në ligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore.”

Manjani thekson se këto ndryshime ligjore kanë rëndësi për një numër të madh qytetarësh që kanë punuar para vitit 1994 dhe nuk kanë mundur të dokumentojnë periudhat e tyre të punës për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore.

Manjani vuri në dukje se,

“projektligji ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore nga mosha 18 vjeç apo nga data e mbarimit të shkollës së lartë deri në datë 19/07/1991 që është data e hyrjes në fuqi e ligjit 7501 për tokën, i ndryshuar”.

Manjani deklaroi se, “projektligji mundëson njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, në rastet e kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi, dhe do të bëjë të mundur përfitimim e një pensioni sa masa e pensionit social”.

Ajo tha se, kosto e shtuar në vitin e parë të zbatimit të këtij projektligji rezulton rreth 40 milionë lekë. Në vlerësimin e kohës mesatare të gëzimit të pensionit, që është 15 vite kosto për këta përfitues, është rreth 600 milionë lekë për këta përfitues.

Deputetja Antoneta Dhima, relatore e projektligjit dha de-

taje të efektit financiar nga zbatimi i këtij projektligji.

“Për personat, që kanë punuar në ish-kooperativa bujqësore, rezultojnë 3,5 milionë muaj të munguar ose 285 mijë vite ku në llogaritje me një vjetërsi të plotë sa kërkohej në vitin 2023 prej 38 vitesh, me një pension mesatar 18 000 lekë në muaj, rezulton një kosto vjetore e shtuar për 7 500 pensione, në vlerën 1,7 miliardë lekë në vit. Për personat, që kanë punuar në ish-ndërmarrjet shtetërore, rezultojnë 10 milionë muaj të munguar ose 827 mijë vite ku në llogaritje me një vjetërsi të plotë sa kërkohej në vitin 2023 prej 38 vitesh, me një pension mesatar (periudhë sigurimi në sektorin shtetëror) 22 000 lekë, rezulton një kosto vjetore e shtuar për 22 mijë pensione, në vlerën 5,2 miliardë lekë në vit” ,tha Dhima.

Pas diskutimeve pr/ligji u miratua dhe tashmë do ti kalojë Kuvendit në seancë plenare për miratimin e qeverisë.



Dy platforma për guida online në 200 agroturizmet shqiptare

Aplikacioni Agritourism AL dhe faqja e internetit agroturizem.gov.al janë dy platforma të përditësuara të agroturizmit shqiptar, të cilat ofrojnë mbi 200 oferta turistike.


Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ndau në rrjete sociale pamjet që ofron klikimi në aplikacionin Agritourism AL, ku zbulohen bukuritë, shijet dhe traditat e Shqipërisë rurale.

Agroturizem AL dhe agroturizem.gov.al janë guida online për të gjithë ata që duan të vizitojnë fermat turistike, të shijojnë produktet lokale, gatimet tradicionale dhe eksperiencën e posaçme që të ofron fshati përmes kësaj dege të re në zhvillim të turizmit shqiptar.

“Çdo ditë të vitit, mund të zgjidhni të vizitoni fermat agroturistike, kampet, kullat, kantinat e verës, artizanët, si dhe të shijoni traditat folklorike dhe prodhimet lokale”, tha Denaj.

Janë mbi 200 ferma turistike dhe rrugëtime drejt staneve, verës, ullirit, agrumeve, midhjes dhe peshkut në dy platformat, që u vlejnjë agrosipërmarrësve dhe vizitorëve të këtyre pikave të bukura të Shqipërisë.

Falë mbështetjes me grante dhe lehtësive fiskale, agroturizmi është një realitet i ri për zonat rurale, në ndihmë të ekonomisë lokale sot e të asaj



kombëtare nesër.

Të gjithë mund të shkarkojnë aplikacionin në App Store

ose Play Store, që sjell agroturizmin shqiptar në smartfonin e gjithkujt.

Denaj: Turizmi do të shtojë kërkesën për produkte vendase, mbështetje të drejtpërdrejtë fermerëve

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj deklaroi se eksportet bujqësore drejt vendeve të BE-së shënuan rritje me 20% në sasi, në vitin 2024.

një nga rritjet më të mëdha në rajon. Shqipëria ka një rritje shumë eksponenciale ekonomike. Bujqësia kontribuon me afërsisht 16,22%. Eksportet në sasi janë rritur me 20% në 2024

në rritje për produkte vendase.

Ajo theksoi se qeveria po mbështet drejtpërdrejt fermerin.

“Në blegtori prodhimi shkon për konsumin vendas dhe prodhimi do jetë në presion. Kemi turistë që vijjnë për këtë arsye, agroturizmi do të jetë një kontribues më i madh dhe farat tona autentike gjithashtu. Kemi një kalkulum që presioni që vjen do t'i tejkalojë eksportet me 1,5 herë”, u shpreh ajo.

Denaj bëri të ditur se po punohet edhe për nxitjen e eksporteve, sikurse për ngritjen e pikave të përpunimit të produkteve bujqësore si dhe agroturizmin.

“Për të angazhuar në sektor, dua të them që formalizimi i ekonomisë së tyre duhet të ndodhë, nuk është vetëm nipti, është lidhja në zinxhir i transaksioneve. Është domosdoshmëri që të fillojë të përkthet dhe në kontribut financash. Është i rëndësishëm për financat. E dyta, është cilësia. 540 milionë euro janë eksporte dhe janë të certifikuara për sigurinë ushqimore”, tha ajo.



Në një intervistë në media, ministria Denaj theksoi se bujqësia ka marrë vëmendje të madhe nga qeveria, ndërsa vuri në dukje edhe se janë trashëguar problematika të mëdha.

Sipas saj, bujqësia ka peshë të madhe në ekonominë e vendit.

“Rritjen ekonomike e kemi 4,09% në Shqipëri dhe është

dhe janë rritur drejt vendeve të Bashkimit Europian. Eksportet tona janë nga fruta-perime, deri te peshku”, tha ajo.

Denaj po ashtu foli dhe për ndikimin e turizmit te ky sektor. Sipas saj, shtimi i numrit të turistëve do të vendosë nën presion edhe sektorin e bujqësisë për t'u përgjigjur kërkesës

KREDITIM

Krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit,
drafti në konsultim publik

Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit njofton hapjen e konsultimit publik të projektligjit "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit" (BSHZH), një nismë strategjike që synon nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, duke adresuar nevojat e sektorëve të nënfinancuar, duke mbështetur projekte zhvillimore me rëndësi kombëtare.

Banka Shqiptare e Zhvillimit do të shërbejë si një institucion financiar, i modeluar sipas praktikave më të mira

evropiane, dhe ka për qëllim: Fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMV), mikrondërmarrjeve dhe start-up-eve, përmes financimeve dhe mbështetjes teknike; Promovimin e eksporteve shqiptare për të forcuar konkurrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare; Kanalizimin e fondeve

dhe instrumenteve financiare nga partnerët ndërkombëtarë drejt projekteve zhvillimore; Modernizimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale të vendit, me një fokus të veçantë në investimet e gjelbra.

Projektligji është përgatitur në bashkëpunim me partnerë strategjikë, përfshirë Cassa

Depositi e Prestiti (CDP) të Italisë, e cila ka ofruar ekspertizë për konceptimin dhe ngritjen e këtij institucioni.

BSHZH do të fokusohet në projekte që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë së Shqipërisë, duke ndjekur standardet më të larta të transpar-

encës dhe llogaridhënies.

Ndër të tjera, institucioni do të sigurojë financime për projekte publike dhe private në nivel lokal e qendror, duke krijuar ura bashkëpunimi mes kapitalit publik dhe privat.

Banka Shqiptare e Zhvillimit do të funksionojë si një shoqëri aksionare, me Shtetin

Shqiptar si aksionarin kryesor dhe një kapital fillestar prej 10 miliardë lekësh.

Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj, deklaroi se, "themelimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit është një gur themeli në përpjekjet tona për të transformuar ekonominë shqiptare. Kjo bankë do të ofrojë mbështetje konkrete për sipërmarrësit, do të promovojë eksportet dhe do të krijojë baza solide për zhvillimin afatgjatë të vendit".

Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit ka nxjerrë për konsultim publik projektligjin "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit".

Projektligji "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit", ka si qëllim themelimin dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e një institucioni financiar zhvillimi, i ngjashëm me bankat apo institucionet kombëtare promovuese që funksionojnë në Bashkimin Evropian, me synim kryesor nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, përmes lehtësimit të qasjes në financë të sektorëve të nënfinancuar të ekonomisë, kryesisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë mikrondërmarrjet dhe start-up-et, si edhe mbështetjes së projekteve zhvillimore që lidhen me përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale, me fokus të veçantë tek investimet e gjelbra.

Bankat dhe institucionet financiare promovuese në BE përkufizohen si entitete që kryejnë veprimtari financiare me një mandat të dhënë nga një shtet në nivel qendror, rajonal ose lokal, për të arritur synime zhvillimore apo promovuese.

Ato luajnë, ndër të tjera,

Banka Shqiptare e Zhvillimit: Shteti shqiptar aksionar
me 51% të kapitalit, përjashtim nga tatimfitimi

edhe rolin e ndërmjetësve financiarë për Bankën Evropiane të Investimeve (BEI), duke kanalizuar linjat e kredive apo instrumente garancie të BEI në ekonomitë lokale.

Disa prej këtyre linjave dhe instrumenteve janë të hapura edhe për vende të Ballkanit Perëndimor dhe gama e tyre zgjerohet edhe më tepër me avancimin në procesin e integritimit.

Arsyetimi kryesor ekonomik për ekzistencën e një institucioni të tillë bazohet në faktin se operimi nën potencial apo dështimet e tregut mund të çojnë në mungesë financimi dhe investimesh që, si rezultat, sjellin një rritje më të ngadaltë sesa ajo që do të ishte ekonomikisht e dobishme apo e synuar. Këto institucione ndërhyjnë në ato segmente që mbeten të nënfinancuara apo të nënshërbyera, duke synuar një qasje plotësuese ndaj financimeve që ofrohen nga operatorët tregtarë financiarë. Veprimtaria e tyre ushtrohet në përpunje me legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe pa

shkaktuar ndikim të padrejtë në konkurrencë.

Objektivat kryesore të këtij institucioni

– Mbështetja e sipërmarrjeve shqiptare

– Promovimi i Eksporteve

Një nga objektivat e BZH, që gjendet edhe në një sërë institucionesh të ngjashme evropiane, është mbështetja e eksporteve shqiptare duke

kanalizuar fonde ose linja financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare, ato evropiane apo partnerë të tjerë të zhvillimit, me fokus te projektet publike në nivel qendror dhe vendor, të cilat kanë përparësi për zhvillimin ekonomik të vendit.

– Zhvillimi i Infrastrukturës Fizike dhe Digjitale

Një nga objektivat e BZH-së do të jetë gjithashtu mbështetja e zhvillimit, përmirësimin dhe modernizimin të infrastrukturës fizike dhe digjitale, në përpunje me objektivat strategjike kombëtare, për të nxitur një ekonomi të qëndrueshme dhe të orientuar drejt teknologjisë.

Në projektligj përcaktohet se Shteti Shqiptar do të jetë aksionari kryesor dhe fillestar i BZH-së, me një pjesëmarrje minimale prej 51% të kapitalit. Gjithashtu, lejohet përfshirja e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe entiteteve të tjera të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Po ashtu përcaktohet se kapitali fillestar i BZH-së do të jetë 10 miliardë lekë,



BZH synon të fuqizojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV) dhe startup-et, duke ofruar financim dhe, sipas rastit mbështetje teknike, për të ndihmuar këto biznese të përmirësojnë produktivitetin, të rrisin konkurrueshmërinë dhe të zgjerojnë prezencën e tyre në tregjet ndërkombëtare.

inkurajuar prodhimin dhe shërbimet që mund të konkurrojnë me sukses në tregjet jashtë vendit.

– Mbështetja e projekteve me rëndësi për zhvillimin ekonomik

Në këtë kuadër, BZH do të veprojë kryesisht në rolin e ndërmjetësit financiar, duke

Çmimi i duhanit shënon rritje pas rritjes së akcizës

Nga 1 janari duhanpirësit po paguajnë më tepër për shkak të rritjes së akcizës për këtë produkt, një politikë kjo e ndërmarrë nga qeveria që qëllim kryesor ka uljen e konsumit.

Në pikat e shitjes me pakicë për çdo paketë çmimi është shtuar me minimalisht 10 lekë.

Deri më 31 dhjetor 2024, detyrimi i akcizës për cigaret apo purot që përmbajnë duhan ishte 7250 lekë / 1000 fije cigare. Nga 1 janari i këtij viti, detyrimi i akcizës për cigaret apo purot që përmbajnë duhan është 7500 lekë / 1000 fije cigare.

Ndryshimet e miratuara nga qeveria në ligjin "Për akcizat" në vitin 2021 vendosën një skedul të ri për rritjen e nivelit të akcizës së duhanit dhe nënprodukteve të tij për periudhën 2022-2026, me qëllim përafërimin me nivelin e akcizës që aplikohet në BE, duke synuar dhe një unifikim të nivelit të akcizës ndërmjet duhanit dhe nënprodukteve të tij.

Ndërsa në Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave 2024-

2027 është parashikuar hartimi i një kalendarit të ri për rritjen e nivelit të akcizës së duhanit



dhe nënprodukteve të tij për periudhën 2027 e në vijim.

Të ardhurat nga akciza programohen 66,984 milionë lekë, ose 2.6 miliardë lekë më shumë se në 2024-ën. Faktorët kryesorë në parashikimin e të ardhurave nga akciza lidhen me rritjen e të ardhurave nga akciza që gjeneron rritja ekonomike shtesë; rritjen e sasive të

importit dhe konsumi i mallrave si karburante, cigare, pije alkooolike, verë, birra etj, si dhe

rritja e nivelit të akcizave për shkak të zbatimit të kalendarit të rritjes së niveleve të akcizës për duhanet.

Për vitin 2025 janë parashikuar të ardhura shtesë nga zbatimi i kalendarit të rritjes së akcizës në shumën prej 852 milionë lekë, si dhe 20% TVSH mbi këtë shumë të rritur akcize.

Qendra "Albanian Night", Gonxhja:
12,000 krijime autentike shqiptare
nga mbi 500 artizanë të talentuar

"Albanian Night" qendra më e re e artit dhe kulturës tradicionale në Tiranë, është kthyer në vendtakimin e rëndësishëm të trashëgimisë kulturore dhe biznesit, ku e kaluara ringjallet për të ushqyer të ardhmen.

Ministri për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin Blendi Gonxhja ndau në rrjetet sociale historinë e Kristinës, që e mësoi artin e endjes në tezgjah nga familjarët e bashkëshortit dhe e pasuroi me ngjyra e motive bashkëkohore.

"Sot, punishtja e familjes Mjeda sjell një ndërthurje të mrekullueshme të traditës dhe modernes, duke mbajtur gjallë trashëgiminë e familjeve qytetare shkodrane", u shpreh Gonxhja, teksa punimet e saj janë të ekspozuara në qendrën "Albanian Night".

Gonxhja tha se, në "Albanian Night", janë ekspozuar 12 mijë krijime artizanale që pro-

movojnë traditën shqiptare.

"Zbuloni mbi 12,000 krijime autentike shqiptare nga mbi 500 artizanë të talentuar në Qendrën Kulturore "Albanian Night," ku tradita gjen vendin e saj përmes mbështetjes nga Qeveria Shqiptare përmes Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë

së Sipërmarrjes dhe Start-Up Albania, si dhe nga Delegacioni i BE-së përmes projektit EU4Innovation, i zbatuar nga GIZ", u shpreh Gonxhja.

"Së bashku mbështesim bizneset shqiptare për të ruajtur identitetin lokal dhe prezantuar ato në tregun evropian", tha ministri Gonxhja.





SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



KËNDI I EKSPERTIT

Nevoja për shoqërues të trajnuar për turistët, vizitorë të zonave fshatare

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

8 janar, 2025



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Bumi turistik që po përjeton vendi ynë, ka edhe një pamje tjetër pozitive, pikërisht shpërndarjen e vizitorëve në të gjithë territoret e vendit, si nga jugu edhe në veri, nga perëndimi në lindje të vendit, nga qytetet edhe në zonat fshatare.

Në zonat fshatare turistët i tërheqin disa fusha vizitash.

Në këto zona turistët shijojnë pejsazhin, larminë biologjike, ushqimin me produkte bujqësore me përdorim të pakët ose të kufizuar të plehrave dhe produkteve kimike për mbrojtjen e bimëve. Këtej shikojnë tipet e banesave, stilin e veshjeve të banorëve në këto zona, zakonet dhe traditat tona fshatare. Në zonat fshatare gjenden edhe vendbanime të lashta, si qytete antike, kala, mure të lashtë, objekte fetare si kisha, xhami, teqe, ullishte shekullore dhe pemë e drurë të tjera historike. Të gjitha këto fusha vizitash kanë nevojë për udhërrëfyes (udhëregues) të trajnuar, të cilat duhet të zotërojnë njohuritë historike, të trashëgimisë, si dhe zhvillimet social-ekonomike në këto zona, si në këto 30 vitet e fundit, por edhe në historinë kur jetonim në një ekonomi të centralizuar, madje edhe në kohë shumë më të vjetra. Këto 30 vitet e fundit, dihet se territori shqiptar ka pësuar ndryshime të mëdha. Përmendim këtu zhvillime pozitive, por edhe negative, të cilët vizitorët e huaj, nuk i dinë dhe ky informacion pasuron njohuritë e tyre mbi Shqipërinë.

Udhërrëfyesit mundet të informojnë turistët, p.sh. për vitet se kur janë ndërtuar rrugët e asfaltuara në zonat fshatare, ndërtimet e reja në stilin e vilave, pikat agroturistike. Në fshatra ka ende ndërtesa të stilit të vjetër dhe këto modele u duhen treguar turistëve. Ashtu si fakti pozitiv i banesave moderne, të bollshme

dhe të bukura, turistëve u duhet shpjeguar edhe urbanistika spontane e 30 viteve të fundit. Lëvizja e popullsisë nga njëra zonë në një tjetër u realizua pa plan, pa rregulla, duke dëmtuar rëndë si tokën bujqësore, pronat, ashtu edhe ndërtimet pa infrastrukturë dhe shijen e rregullsisë.

Gjatë udhëtimit dallohen kodra të tarracuara, dikur të mbjella me pemë e vreshta, porse sot kanë mbetur vetëm tarracat në miniaturë.

Nga majat e kodrave duken kufijtë e vjetër të parcelave të piketuara nga 10 hektarë secila, porse sot pas privatizimit, parcelat janë coptuar duke e zvogëluar fermën bujqësore me një mesatar 1,3 ha për familje fermere, sipërfaqe e cila ka ulur forcën konkurruese të fermerit tonë në tregun e hapur dhe agresiv.

Kur autobuzët kalojnë nëpër fushën e Myzeqesë, fushën e Korçës, të Vrinës, të Torrovcës, në tarracat e bregdetit të jugut, ullishtet në vargkodrat e Rogozhinës e deri në kodrat e Lushnjës dhe Beratit, të gjitha këto janë objekte me histori, që duhen shpjeguar. Kur shkohet p.sh. në Lurë, shoqëruesit të kenë edhe fotot e vjetra të liqenjve të Lurës, se si ato kanë qenë të rrethuara nga pyjet dhe si janë sot liqenjtë e Lurës pas masakrës pyjore të pas viteve 1990.

Edhe hidrocentralet kanë historinë e tyre edhe rrugët kanë historinë e tyre. Të dihet nga udhëtarët e huaj kur është ndërtuar rruga e Kombit, e cila lidh Shqipërinë me Kosovën, rrugët e tjera të reja vetëm këto 20 vitet e fundit etj.

Kur kalohet pranë hekurudhave t'u shpjegohet turistëve se si Shqipëria sapo u çlirua pas Luftës së Dytë Botërore, filloi ndërtimin e hekurudhave, duke ndërtuar deri në fund të viteve 1990, 452 km hekurudhë dhe sot janë të shkatërruara nga vetë shqiptarët me nxitje nga brenda dhe jashtë Shqipërisë.

U tregohen qytezat si Kamza, një qytet tipik që pasqyron spontanitetin urbanistik të pas viteve 1990. Në atë apo atë fshat ku kalojnë turistët, t'u tregohet atyre se sa banorë kishte para viteve 1990 dhe sa banorë ka sot. Pra duhet qartësuar si erozioni i brendshëm i popullsisë, ashtu edhe largimi i shqiptarëve në vendet e tjera në Europë dhe jashtë saj etj. etj.

Pa një sy të trajnuar, kufijtë e parcelave të vjetra me mezhdra të gjelbëruara, nuk dallohen. Turistëve u duhet qartësuar se si sistemi socialist shtetëzoi çdo mjet prodhimi, mbi të gjitha shtetëzimin e tokës. T'u shpjegohet edhe se çfarë ishte tufëzimi i bagëtive dhe pagat e puntorëve të bujqësisë.

Turistëve u duhet treguar edhe pasojat ekonomike nga embargoja e ashpër të botës perëndimore

ndaj Shqipërisë, e cila u shtri deri tek gozhdët dhe guzhinetat e traktorëve.

Pjesë e pejsazhit të zonave fshatare janë edhe bunkerët për qëllime mbrojtjeje në kohën e Luftës së Ftohtë.

Bunkerët nuk duhen komentuar as me ndiejën e krenarisë, por as me pranimin e një fajsie të madhe. Bunkerët janë pasojë, shkak ishte militarizimi i botës perëndimore dhe Bashkimit Sovjetik, në kuadrin e asaj që në histori përmendet me termin "Lufta e Yjeve".

Kur bota perëndimore na largoi frikën se nuk do të na sulmojnë, ishte vetë populli që i shkatëroi bunkerët. Pra ndërtimi i bunkerëve duhet të jetë shkas që të shikohen të padobishme, si raketat e tanket sulmuese, ashtu edhe bunkerët mbrojtës. Bunkerët kanë karakterin e tyre historik, ashtu si klatë dhe muret mbrojtës të qyteteve. Edhe sot nuk jemi pa bunker mbrojtës. Sot për Shqipërinë "bunker mbrojtës" është NATO-ja. Kjo organizatë ka krijuar një paqe dhe siguri për kufijtë e Shqipërisë dhe për të gjithë Europën.

Kohët e fundit riarmatimi i blloqeve të mëdha politike të botës, po i kthen shqiptarët te rihapja e fabrikave dhe uzinave të dikurshme të armëve, te shtimi i ushtarëve në rradhët e ushtrisë, në ngritjen e bazave ushtarake të reja, në përforcimet e mbrojtjes civile dhe të tjera masa mbrojtëse.

Me këto informacione, turistët besoj se do të ndihen më të plotësuar në njohuritë e tyre mbi Shqipërinë. Pas çdo udhëtimi turisti të thotë me veten e tij: "Ky udhëtim nuk ishte kohë e humbur për mua", diçka mësuam nga udhëreguesi, sepse me pamje nga autouzi, nuk do të mund t'i mësonin.

Ata janë në gjendje të kuptojnë edhe punët tona të mira që kemi bërë dhe sot, dështimet tona dhe sot. Ata gjithashtu gjykojnë më me objektivitet edhe politikat e mira mbështetëse ndaj Shqipërisë, dhe ato politika jo shumë efektive që kanë bërë vendet e tyre ndaj Shqipërinë, si dje edhe sot.

Këto qartësime turistëve mund t'ua bëjnë udhërrëfyes të trajnuar, të cilët njohin mirë historinë e djeshme dhe të sotme të zonave fshatare.

Ministria e TURIZMIT DHE MJEDISIT shpresoj që të realizojë një botim të tillë që të përdoret pikërisht nga këto shoqërues të turistëve në zonat fshatare. Këto botime janë edhe lëndë e parë për trajnimin e tyre. Çdo Bashki e Madhe, gjithashtu e ka të nevojshme të realizojë botime të kësaj natyre, për zonat e veta fshatare dhe t'ua afrojë pikërisht shoqëruesëve të turistëve.



AKTUALITET

Prokurimi i Qëndrueshëm në Fokusin e OBP-së

Një hap i rëndësishëm drejt përbushjes së objektivave globale për qëndrueshmëri dhe përgjegjshmëri është hedhur falë trajnimit të organizuar nga UNOPS mbi prokurimin e qëndrueshëm me Operatorin e Blerjeve të Përqendruara (OBP)sha. Ky workshop 2-ditor, që mbledhi së bashku profesionistë dhe ekspertë të fushës, shërbeu si një platformë për ndarjen e praktikave më të mira dhe përvetësimin e qasjeve të reja që forcojnë aspektet mjedisore dhe sociale në proceset e prokurimit publik.

Roli kyç i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara

Në këtë kontekst, roli i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, si organi qendror blerës për prokurimet publike, i cili ka qenë jetik gjatë këtyre 9-muajve nga data e themelimit që daton 25 Prill 2024. Ky institucion, krahas kryerjes me sukses të detyrave të përditshme, ka marrë një iniciativë të rëndësishme për prokurimin e qëndrueshëm, duke iu bashkuar kështu një nisme globale

për forcimin e dimensioneve mjedisore dhe sociale në prokurim.

“Puna e Operatorit të Blerjeve të Përqendruara dëshmon se angazhimi institucional për qëndrueshmëri është më shumë sesa një prioritet strategjik – është një detyrim ndaj së ardhmes sonë,” deklaroi Administratorja e këtij institucioni znj. Arlinda Pogaj.

Ky institucion jo vetëm që siguron efikasitet në prokurimet publike, mbi 17.5

milion euro kursime nga buxheti i shtetit në vetëm 8 muaj të vitit 2024, tashmë po udhëheq përmes shembullit në ndërtimin e një modeli në prokurime publike në vëndin tonë.

Një mundësi për zhvillim profesional dhe strategjik

Trajnimi ofroi stafit të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara dhe pjesëmarrësve të tjerë:

- Njohuri të avancuara mbi integrimin e qëndrueshmërisë

në prokurimet publike.

- Mjete praktike për përfshirjen e indikatorëve socialë dhe mjedisorë në procedurat e prokurimit.

- Një platformë për ndarjen e përvojave dhe bashkëpunimin me partnerë të tjerë strategjikë.

Për një të ardhme të qëndrueshme!

Kjo iniciativë, e drejtuar nga UNOPS dhe mbështetur nga Operatori e Blerjeve të Përqendruara, përfaqëson një hap të madh drejt

përmirësimit të proceseve publike përmes prokurimeve me ndikim pozitiv për mjedisin dhe shoqërinë.

Së bashku, për një të ardhme më të qëndrueshme!

Ky artikull është një dëshmi e përpjekjeve të përbashkëta për të krijuar një sistem prokurimi që ndihmon në ndërtimin e një bote më të drejtë dhe më miqësore ndaj mjedisit, një nismë e OBP sha që po punon fort me perkushtim dhe profesionalizëm.!



UBT-BOKU 2030, Denaj: Fuqizojmë arsimin dhe kërkimin shkencor në bujqësi

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj priti në një takim të veçantë, profesor Hubert Hasenauer, ish-ректор i Universitetit BOKU të Vjenës, rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës Fatbardh Sallaku dhe rreth 50 studentë të UBT-së.

Denaj tha se, gjatë këtij takimi u bisedua mbi ecurinë e projektit UBT-BOKU 2030, që synon të fuqizojë arsimin dhe kërkimin shkencor në bujqësi.

Ministrja vuri në dukje se, me modernizimin e arsimit bujqësor, ky partneritet ndërkom-bëtar sjell më shumë mundësi

për rreth 6000 studentë për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm të sektorit.

“UBT, tashmë në rrugën drejt një Qendre Ekselence Rajonale, do të ofrojë diploma të dyfishta dhe programe të reja akademike me standarde si Universiteti BOKU i Vjenës”, tha Denaj.



Banka e Shqipërisë, masa ndaj sfidave mjedisore

Banka e Shqipërisë po punon për diversifikimin e portofolit të kredisë në financimin e projekteve dhe investimeve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe në mbrojtje të mjedisit.

vestimi i tyre në mjedis.

Në një intervistë për mediet, Tanku theksoi se, “në rast se një institucion financiar, bankë ose jo bankë, ka dhënë një kredi për ndërtimin e një hoteli në

terive, në qoftë se nuk tregohet kujdes për mjedisin, ajo mundet që të ndotë mjedisin dhe kjo do të ndikonte negativisht në investimin tjetër që banka ka bërë në hotel”.

Sipas tij, Banka e Shqipërisë ka hartuar edhe një strategji prej së cilës janë përgatitur disa udhëzues për bankat dhe institucionet financiare mbi ndikimin që kanë ndryshimet klimatike në ekonomi.

“Banka e Shqipërisë po punon për atë që quhet taksonomi, që është një sistem i cili klasifikon aktivitetet ekonomike, financiare, të gjitha aktivitetet në ekonomi, produktet, mallrat, shërbimet, sipas impaktit të gjelbër që kanë, i cili përmbledh ndikimet në klimë, ato mjedisore, në shumëllojshmërinë e florës dhe faunës në natyrë, e të gjitha me radhë”, tha Tanku.

Banka e Shqipërisë ka nënshkruar së fundi një marrëveshje me Bankën Evropiane të Investimeve për zhvillimin e një ekonomie më të gjelbër dhe më rezistente.



Banka Qendrore, vitet e fundit ka zgjeruar kontributin e saj, në përgatitjen e analizave dhe kërkimeve rreth çështjeve të ndryshimeve klimatike.


Altin Tanku, drejtor i Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, u shpreh se një prej masave që bankat ndërmarrin lidhur me sfidat mjedisore, është vlerësimi i aplikimeve për kredi të individëve dhe bizneseve në bazë të ndikimit që do të ketë in-

breg të detit, në grykëderdhjen e një lumi të themi. Në rast se, në të njëjtin institucion financiar vjen për të marrë kredi edhe një kompani e cila do të bëjë fabrikë për ndërtimin e baterive të makinave. Pyetja shtrohet a duhet ta japë kredinë banka? A duhet ta vlerësojë nga këndvështrimi mjedisor kredinë, ky institucion financiar? Sepse dihet, natyrisht kur ndërton një fabrikë, që ka si synim të vet ndërtimin e ba-

BUJQËSI

Rivitalizimi i Tregut të Fruta-Perimeve në Elbasan, miratohet fondi për shpronësimet

Këshilli i Ministrave miratoi fondin për shpronësimin e pronarëve të pasurisë private që do të preken nga realizimi i projektit të "Rivitalizimit dhe Rikonstruksionit të Tregut



Fruta-Perime" në lagjen "Kongresi i Elbasanit".

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, vendimi parashikon shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë të paluajtshme, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 1.41 milionë lekë, kompensimi i të cilëve do të bëhet nga buxheti i Bashkisë Elbasan. Shpronësimi do të nisë menjëherë pas botimit

në "Fletoren Zyrtare" dhe do të përfundojë brenda 3 muajve. Bashkia Elbasan është autoriteti që kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

Procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan do të kryhen nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Vendimi i plotë:

V E N D I M

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIVITALIZIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I TREGUT FRUTA - PERIME NË LAGJEN "KONGRESI I ELBASANIT", NË ZONËN KADASTRALE 8521", BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes

publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Rivitalizimi dhe rikonstruksionit të tregut fruta - perime në lagjen "Kongresi i Elbasanit", në zonën kadastrale 8521", Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme, prej 1 410 660.46 (një milion e katërqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pikë dyzet e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimi, prej 1 410 660.46 (një milion e katërqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pikë dyzet e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimi të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasurinë e shpronësuar sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

Shqipëria në "Wine Paris 2025", për herë të parë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Verës

Shqipëria po konsolidon promovimin ndërkombëtar të verës dhe po zgjeron tregjet e shitjes për produktet "Made in Albania".

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), bën të ditur se, Shqipëria për herë të parë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (OIV) do të prezantohet në panairin "Wine Paris 2025".

Në "Wine Paris 2025", që mbahet në 10-12 shkurt 2025, në Paris - Porte de Versailles, Francë, Shqipëria do të prezantohet për herë të parë me verërat e saj unike, duke shfrytëzuar këtë anëtarësim për të rritur eksportet dhe për të krijuar mundësi të reja bashkëpunimi me tregjet ndërkombëtare.

Shqipëria u bë shteti i 50-të anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (OIV) më 16 gusht 2023, duke shënuar një hap historik që forcon pozicionin e saj në industrinë globale të verës dhe sjell përfitime të shumta për prodhuesit shqiptarë.

Përfitimet janë në përfundim me standardet ndërkombëtare, duke rritur cilësinë dhe konkurrueshmërinë e verës shqiptare; qasje në studime dhe statistika globale, që ndihmojnë në zhvillimin strategjik të sektorit; lehtësim të depërtimit në tregjet ndërkombëtare, duke rritur besueshmërinë e prodhimeve tona si dhe pjesëmarrje në vendimarrjen globale, duke ndikuar në politikën e industrisë së verës.










Shqipëria është shteti i 50-të në botë i anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (OIV)

Burimi: Organizata Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (OIV)

Fillon ndërtimi i rrugës së Komanit, Beci: Pikënisje e eksplorimit të Alpeve për mijëra turistë

Kryetari i bashkisë së Shkodrës, Benet Beci bëri me dije se ka filluar ndërtimi i rrugës së Komanit. Kjo rrugë, sipas tij, i shërben një numri të konsiderueshëm banorësh të bashkisë Vau i Dejës, lidh hidrocentralet me njëri-tjetrin dhe është pikënisja e eksplorimit të Alpeve për mijëra turistë nga e gjithë bota.

Sipas Becit, gjendja e degraduar në të cilën ndodhej kjo rrugë deri përpara nisjes së investimit, e bënte atë një ftesë jo dinjitoze për turizmin në veri e në të gjithë vendin.

"Para disa vitesh në cilësinë e drejtuesit të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), me mbështetjen e qeverisë, ndërmora nismën për financimin e ndërtimit nga të ardhurat e korporatës, plotësisht i bindur se përtej të qenit e domosdoshme ishte detyrim i korporatës ndaj banorëve të zonës pas dekadash të shfrytëzimit të luginës së Drinit për prodhim energjie elektrike për të

gjithë vendin. Ishte dhe një nga angazhimet kryesore si deputet i zgjedhur i qarkut Shkodër në 2021", shprehet Beci.

"Kombinimi i një sërë të papriturash si, gjendja financiare e rënduar pas krizës energje-



tike, stërzgjatja e procedurave administrative e gjyqësore për lidhjen e kontratës, personalisht më patën lënë barrën e rëndë të një premtimi të paralizuar, por mbi të gjitha duke mbajtur zonën peng të një mundësie të jashtëzakonshme zhvillimi", thotë Beci.

Kryebashkiaku i Shkodrës, rikujton faktin se vjet kryeministri Edi Rama premtoi që rruga do të fillojë me çdo kusht, pavarësisht nga kostoja jo e vogël e investimit.

"Kjo është një fitore e

madhe për mundësitë e zhvillimit në qarkun Shkodër dhe jam i sigurt që është vetëm hapi i parë i një sërë nismave publike e private që kanë për të futur në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm një nga zonat më të bukura të vendit", thekson Beci.

Shitja e agrumeve nën kosto - Fermerët në Lushnjë e Fier, po i zëvendësojnë ato duke mbjellë ullinj

Momentalisht është koha e mbjelljes së fidanëve dhe fermerët po kryejnë mbjelljet e reja. Në Kolonjë të Lushnjës dhe Vajkan të Fierit kërkesat për fidanët e ullirit kanë trefishuar çmimin. Kjo pasi ka kërkesë për blerjen e tyre, pasi fermerët po heqin dorë nga agrumet për shkak të shitjes nën kosto të prodhimit dhe stokut të krijuar.

"Ulliri kërkohet më shumë

sivjet, janë shtuar shumë kërkesat dhe nuk ka ullinj", u shpreh fermeri Qani Dërka.

Fermerët pohojnë se gjatë 5 viteve të fundit nuk ka pasur kërkesa për mbjelljen e ullinjve, ndaj ata kanë prodhuar pak fidanë. Këtë vit gjithçka ka ndryshuar, është rritur kërkesa dhe çmimi.

"Kërkojnë ullinj koronet ndërsa mandarinat i shitëm me 250 lek", u shpreh Aris Alla,

një tjetër fermer.

Fidanët prodhohen në kushte serre nga vet fermerët të cilët ankohen se nuk gjejnë dot punëtorë. Sipas tyre ata punojnë në familjarisht pasi të rinjtë kanë emigruar duke detyruar moshat e treta të merren me bujqësi. Fidanët e ullirit kërkohen të mbillen me shumicë në qarqet e Tiranës, Beratit, Durrësit dhe Shkodrës.

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji shkurt 2025

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

do të mbetet në thelb konstante 29% gjatë gjithë kohës, mundësia e një dite me borë dhe shi të përzier do të mbetet në thelb konstante 1% gjatë gjithë kohës

Pamja e qiellit gjatë muajit shkurt 2025

Më 12 shkurt - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga

Parashikimi i motit për muajin shkurt 2025 në Tiranë (Zona bregdetare)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. It provides daily weather forecasts for Tirana from Jan 1 to Jan 28, 2025.

Parashikimi i motit për shurtk 2025 në Korçë (Zona e ftohtë)

Table with columns: Dt., Temperatura e ajrit °C, Temp. reale që ndjehet °C, Shiu (mm, Orë), Era (Km/Orë, Drejtimi), UV Indeks, Zhvillimi i reve dhe reshjet, Simboli. It provides daily weather forecasts for Korça from Jan 1 to Jan 28, 2025.

Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 14:53 UTC. Kjo Hënë e plotë njihet nga fiset e hershme vendase amerikane si Hëna e borës, sepse bora më e madhe zakonisht binte gjatë kësaj periudhe të vitit. Duke qenë se gjuetia është e vështirë, kjo Hënë është njohur nga disa fise edhe si Hëna e Urisë, pasi moti i ashpër e vështirësonte gjuetinë.

Më 28 shkurt - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtin anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 01:44 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objekte të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të Hënës që të ndërhyjë.

Parashikimi i motit për muajin shkurt 2025

Shkurti në Tiranë është i ndikuar nga klima bregdetare mesdhetare. Kur udhëtoni për në Tiranë në shkurt mund të prisni: zakonisht reshje shiu, herë pas here mjegull, ndonjëherë stuhi, borë e rrallë. Gama e temperaturave mesatare të ditës do të jetë rreth 11°C dhe 18°C. Zakonisht java e tretë është më e nxehta në shkurt, mbani parasysh mundësinë e reshjeve të shiut, bubullimës dhe mjegullës. Ngjarjet e motit që mund të ndodhin gjatë udhëtimit për në Tiranë: 17 herë Shi, 2 herë Mjegull, 6 herë Bubullima (Stuhi), më pak se 1 herë Borë. Tirana në shkurt do të përjetojë ditë të freskëta me një qiell pothuajse të plotë të vranët. Në mënyrë tipike, temperatura do të

Treguesit mesatarë klimatike gjatë muajit shkurt 2025

Table showing average climate indicators for Tirane, Korçe, Vlore, Shkoder, Dibër, and Gjirokastrë. Includes rows for temperature (Mesatare, Maksimale, Minimale), precipitation (Numuri i ditëve me Temperaturë +30°C, +18°C, +0°C), wind speed (Shpejtësia e erës), and other metrics.

luhatet rreth 14°C dhe do të ndihet për 12°C dhe era do të jetë fllad i lehtë.

Temperaturat e larta ditore do të rriten me 2°C, nga 12°C në 13°C, rrallë do të bien nën 7°C ose të kalojnë 18°C.

Temperaturat e ulëta ditore do të rriten me 2°C, nga 1°C në 2°C, rrallë do të bien nën -4°C ose do të kalojnë 7°C.

Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperaturat në Tiranë zakonisht variojnë nga 18°C në 32°C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga 0°C në 11°C.

Zhvillimi i reve

Muaji shkurt në Tiranë do të

përjetojë në thelb një mbulesë të vazhdueshme me re, me përqindjen e kohës që qielli është me vranësira ose kryesisht me re, do të mbetet rreth 52% gjatë gjithë muajit. Mundësia më e lartë e kushteve me vranësira ose kryesisht me vranësira do të jetë 53% më 23 shkurt.

Dita më e kthjellët e muajit do të jetë 14 shkurti, me kushte të kthjellëta, kryesisht të kthjellëta ose pjesërisht me vranësira në 50% të rasteve. Gjatë muajit shkurt mbulimi mesatar i reve do të jetë 58%.

Për referencë, më 7 dhjetor, dita më e vrenjtur e vitit, shansi i kushteve të mbuluara me re ose më së shumti me re është 55%, ndërsa më 21 korrik, dita më e qartë e vitit, mundësia e qiellit të pastër, është 91%.

Zgjatja e Ditës

Në shkurt, gjatësia e ditës gradualisht fillon të rritet me rreth 68 minuta. Dita më e shkurtër do të jetë 1 shkurti dhe ofron 10 orë e

Kalendari, fazat e hënës dhe shënjat astrologjike për muajin shkurt 2025

Table showing moon phases and astrology signs for each day of the month. Columns include: Dt., Dita, Dita e Vitit, Dielli (Lind, Perëndon), Zgjatja e ditës, Hëna (Lind, Perëndon), Fazat e Hënës (Faza, %), and Shënjat Astrologjike.

4 minuta dritë dite, lindja e diellit do të jetë në orën 6:53 e mëngjesit dhe perëndimi i diellit do të jetë në orën 16:57 dhe dita më e gjatë do të jetë 28 shkurti me 11 orë 13 minuta ditë, lindja e diellit do të jetë në orën 6:18 e mëngjesit dhe perëndimi i diellit do të jetë në orën 17:3. Për një udhëtar, numri i orëve të diellit është shumë i rëndësishëm. Ky muaj ofron mesatarisht 11 orë dite.

Për referencë, më 21 qershor, dita më e gjatë e vitit, Dielli lind në orën 5:07 të mëngjesit dhe perëndon 15 orë dhe 10 minuta më vonë, në orën 20:17, ndërsa më 22 dhjetor, dita më e shkurtër e vitit, dielli lind në orën 7:03 të mëngjesit dhe perëndon 9 orë e 11 minuta më vonë, në orën 16:14.

Reshjet

Fjala që përshkruan më së miri motin në shkurt është mot i

lagur. Shkurti so të jetë kryesisht muaj i lagësht. Të gjithë duhet të jenë të përgatitur për shi, mjegull, stuhi dhe borë gjithashtu.

Shprehja që në përgjithësi përshkruan më së miri motin në shkurt është se do të jetë mot i lagësht dhe me shi.


Në Tiranë, mundësia për një ditë të lagësht gjatë muajit shkurt do të jetë në thelb konstante, duke mbetur rreth 31% gjatë

dhe mundësia e një dite me vetëm borë mbetet në thelb konstante 0% gjatë gjithë kohës.

Për referencë, mundësia më e lartë ditore e vitit për një ditë të lagësht është 36% më 5 dhjetor dhe shansi më i ulët i tij është 10% më 7 korrik.

Mesatarja e akumulimit të reshjeve 28-ditore gjatë muajit shkurt në Tiranë do të jetë në thelb konstante, duke mbetur

Parashikimi i reshjeve në Shqipëri për muajin Shkurt 2025



gjatë kohës. Gjatë muajit shkurt në Tiranë, mundësia e një dite vetëm me shi

rreth 70 milimetra gjatë të gjithë



KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji shkurt 2025

Kalendari i ditëve më të mira të muajit shkurt 2025 për disa aktivitete të përditëshme të fermerit

Table with 2 columns: Data, Punët dhe aktivitetet që mund të kryhen. Contains 28 rows of daily agricultural tasks and schedules.

Kalendari hënor i të ushqyerit të njerëzve për muajin shkurt 2025

Table with 2 columns: Dt., Përshkrimi i të ushqyerit gjatë ditës. Contains 28 rows of daily nutrition and health advice for humans.



PËRFITO

NORMAT MË TË MIRA
TË INTERESIT



Depozita e Artë

- Hap depozitën **36 Muaj**
- Normë interesi deri në **4.5%** në Lekë dhe **3.5%** në Euro

Skano për
më shumë

